



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 548/Prot

Datë 08.02 2021

VENDIM

NR. 14, DATË 05.02.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 36, DATË 05.03.2020 "PËR  
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË POGRADEC  
DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "ç", nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 " Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2, shkronja "c", Ligjit nr. 10 405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 165, date 02.03.2016 për "Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ligjit 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vkm-së nr. 1149, datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 175, datë 8.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar, Vkm-së nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 141, datë 17.06.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 51, datë 14.02.2020 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe Institucioneve në varësi për vitin 2020", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 144, datë 24.12.2020 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2021", për shkak të ndryshimit të pagës minimale,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 36, datë 05.03.2020 të Këshillit bashkiak të ndryshuar me vendimin nr. 71, datë 19.06.2020 dhe me vendimin nr. 122, datë 21.10.2020, bëhen këto ndryshime:

a) Tabela nr. 1 "Niveli i pagave të punonjësve mësimorë dhe mësuesve ndihmës në arsimin parashkollor", e Vendimit nr. 122, datë 21.10.2020, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij,

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com



b) Pika nr. 3 e Vendimit nr. 36, datë 05.03.2020 ndryshon si në vijim:

- i. Paga minimale bruto mujore e punonjësve të shërbimit të Njësive Administrative, Klubit Shumësportësh, Qendrës Kulturore, Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit dhe Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike është në nivelin **30.000** lekë.

c) Pozicionet e punës (Punonjës shërbimi) që janë paguar me pagën bazë 26 000 do të paguhen me pagën bazë 30 000.

2. Ky Vendim i shtrin efektet financiare prej datës **01.01.2021**.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Pogradec, si dhe të gjitha Ndërmarrjet e varësisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Tabela nr. 1- NIVELI I PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE MËSUESVE NDIHMËS NË ARSIMIN PARASHKOLLOR**

EMËRTIMI/ POZICIONI	Paga individuale			Shtesa për pozicion
	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për Vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
Drejtor Kopshti pa ushqim	1	2 % e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	48 900
Edukator në kopsht fëmijësh	1	2 % e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	42 200
Edukator në kopsht fëmijësh, Edukator ndihmës në kopsht fëmijësh,	2	2 % e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	39 100

**KRYETARI I KËSHILLIT**  
Sotiraq MANGËRI



<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)